

një mbi një çatitë

njëmijë e një mundësitë




PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK



BASHKIA BERAT

BASHKIA E BERATIT

Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik
2005 – 2010





Ky plan strategjik është hartuar nga grupe të gjera të interesuara, nga Bashkia e Beratit nën drejtimin dhe këshillimin e Grupit të Bankës Botërore, Institutit të Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG. Grupi i Bankës Botërore, Instituti i Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG nuk mbajnë përgjegjësi për saktësinë ose përmbajtjen e strategjisë; megjithatë ato përgëzojnë Bashkinë për cilësinë e punës së bërë.



*Kopertina Kilica Graphics
Redaktorë: Artan Rroji dhe Dr. Iain Wilson
Përktheu Marsela Dhimitri
Shtypur në Maluka shpk*

E drejta e botimit © 2006 Bashkia e Beratit

Përmbajtja	faqe
Shkurtime	6
Mirënjohje	7
Fjala përshëndetëse e kryetarit të bashkisë.....	8
I. Parathënie.....	10
II. Hyrje.....	11
III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë	12
IV. Plani Strategjik.....	13
Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik	14
V. Zhvillimi i Planit Strategjik	15
Parimet orientuese.....	15
Metodologjia.....	16
Procesi i planifikimit.....	16
Qasja organizative për hartimin e Planit Strategjik	17
Grafiku kohor i procesit të përgatitjes së draftit të Planit	18
Forumi DELTA i kryetarëve të bashkisë.....	18
Pjesëmarrja dhe konsultimi.....	19
Grupet e Punës në zhvillimin e Planit të ZhEV për Beratin	21
Procesi i miratimit të Strategjisë së ZhEV.....	22
Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore.....	22
Perceptimi i bizneseve	23
Vizioni dhe Qëllimet.....	24
Përfitimet e pritshme	26
Zbatimi i Planit	27
Qasja organizative për zbatimin e Planit.....	27
Financimi i Planit Strategjik	28
VI. Vështrim i përgjithshëm i komunitetit të Beratit.....	29
Klima.....	29
Historiku	29
Demografia.....	30
Qeveria bashkiake.....	31
VII. Profili ekonomik i Beratit.....	35
Përparësitë kryesore të bashkisë së Beratit	36



Bizneset private në qytetin e Beratit	37
Agrobiznesi	38
Artizanati	39
Bizneset e tjera	40
Vizitorët	41
Mundësitë e komunikimeve	42
Arsimi	42
Kosto e jetesës	44
VIII. Dokumentet përbërëse të Planit Strategjik	46
a. SWOT, analizë konsoliduar	47
b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit	49
c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik	54
d. Matrica e prioriteteve të projekteve	62
e. Projekt fishat	65
Aneksi. Raporti mbi “Monitorimin i krijimit të klimës së biznesit në qytet”	117

B OLLSHMËRIA NË BUJQËSI DHE PUNËT BUJQËSORE

E KONOMI TRADICIONALISHT ME POTENCIALE

R ESURSET, HAPËSIRAT DHE MUNDËSITË

A LTERNATIVA PËR TURIZMIN HISTORIK

T RADITA QË NUK DO TË SHUHEN



Shkurtime

DELTA	Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave
KZhEB	Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
DZhEB	Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
LGI	Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (pjesë e Institutit Shoqëria e Hapur e Fondacionit Soros)
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PSZhEV	Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik Vendor
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
BB	Banka Botërore

Mirënjohje

Ky dokument është përgatitur nga Drejtoria e Programit dhe Zhvillimit në bashkinë e Beratit, në mënyrë të veçantë nga Drejtori, Z. Emiljano Zhuleku, inxhinier dhe Z. Qebir Isaraj, statisticien, si edhe me ndihmën e ekspertit Z. Erind Kraja, lehtësues nga programi DELTA.

Ne falenderojmë për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre në krijimin e bazës së të dhënave drejtoritë e bashkisë së Beratit, institucione dhe OJQ të ndryshme që veprojnë në territorin e bashkisë sonë.

Një falenderim i veçantë bëhet për Drejtorinë e Rajonale të Monumenteve të Kulturës dhe drejtorin e tij Z. Ajet Nallbani, kontributi i të cilit bëri të mundur një program të përmirësuar.

Çdo bashkëpunim, ide apo opinion i ri që do ta përmirësonte këtë material do të vlerësohej shumë.

Për informacion ose asistencë të mëtejshme lutemi të kontaktoni:

Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit, bashkia Berat

Tel: +355 (032) 34453

Cel: +355 (069) 2425263

E-mail: zhuleku73@yahoo.com



Fjala përshëndetëse e kryetarit të bashkisë

Të përshkruash një qytet me një trashëgimi kulturore unike përballë një sfondi të bukur dhe të zhvillosh vizionin për të ardhmen e tij brenda kuadrit të sfidave të mëdha të mijëvjeçarit me të cilat po përballemi na bën të ndihemi të veçantë. Nuk ka se si të ndihesh ndryshe kur shikon një qytet me 24 shekuj histori; një qytet që po rritet si në madhësi dhe në ekonomi, por që ende ruan dhe zhvillon vlerat e tij të trashëguara nga të gjitha fushat shoqërore. Ne jemi fëmijët e tij dhe çdo gjë në qytet është bërë pjesë e jona. Ne mund të shikojmë historinë e tij dhe të kërkojmë aty për mundësi, burime dhe hapësira të krijuara nga vlerat e tij kulturore dhe historike.

Berati ndodhet në brigjet e lumit Osum. Pozita e tij gjeografike i ka dhënë mundësi zonës të zhvillojë një histori shumë të lashtë, të treguar në një ekonomi, tradita dhe kulturë që janë rrënjësor thellë në historinë njerëzore. Burimet njerëzore dhe fizike të qytetit kanë qenë një gjenerues i fuqishëm i zhvillimit në një të kaluar plot krenari, një të tashme të konsoliduar dhe një të ardhme plot shpresë dhe optimiste. Tabloja e dhënë këtu mund të mos jetë e plotë në lidhje me thellësinë e mbulimit, por i bën një përmbledhje asaj që mund të shihet dhe të preket, dhe asaj që heshtur krijon një energji për një zhvillim të tashëm dhe të ardhëm për të cilin ëndërron komuniteti i qytetit.

Kjo e ardhme vjen nga potencialet rajonale të zhvilluara së fundmi, që bazohen në lëndën e tij të parë të madhe dhe burimet njerëzore në rritje. Ajo do të zhvillohet në linjë me progresin aktual dhe do të marrë formë nga shumë vështirësi që shfaqen para nesh. Vizioni ynë mbështetet nga fakti që qytetin pak e ndan për t'u bërë anëtar i familjes së UNESCO, rezultat i trashëgimisë dhe përpjekjeve që bëhen për të ruajtur vlerat e tij nëpërmjet investimit.

Komuniteti ynë ndërton, prodhon dhe investon. Ai është pjesë e një rajoni që ka shumë hapësirë për të ofruar dhe në këtë mënyrë ka edhe mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm. Të gjithë aktorët e përfshirë në zhvillimin e Beratit, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe me partnerë që kanë projektuar dhe po projektojnë potenciale të konsiderueshme, janë dhe do të mbeten modeluesit e së ardhmes.

E ardhmja është premtuese. Berati është një qytet me tradita, kulturë, një nivel në rritje të arsimit dhe infrastrukturë në përmirësim me shumë investime që bëhen në fushën e prodhimit dhe të ofrimit të shërbimeve, dhe një zonë në zhvillim të turizmit historik dhe ekoturizmit

Më tej, në Berat janë të pranishme rezerva të pafundme të energjisë së brendshme, të demonstruara në gamën e produkteve të agrobiznesit vendas, të cilat po bëhen gjithnjë e më shumë konkurruese, duke i bërë ata lojtarë si në tregjet kombëtare dhe ato të huaja. Këto biznese po rriten dhe kjo rritje do të sjellë një të ardhme më të mirë për qytetin.

Të gjithë treguesit e paraqitur në këtë botim formojnë vetëm një pjesë të këtij qyteti të bukur, të lashtë. Ai është një portret i vogël i hapësirës së mrekullueshme të krijuar nga ky qytet fisnik i bardhë i njerëzve me shpirt fisnik.

Materiali i paraqitur këtu është një nga produktet e procesit të filluar për zhvillimin e një Plani Strategjik për zhvillimin ekonomik të qytetit të Beratit. Ky Plan u zhvillua dhe po zbatohet në kuadër të programit DELTA, me mbështetjen e Bankës Botërore, fondacionit Soros dhe FLAG. Ai duhet parë si një përpjekje për të stimuluar kapacitetet dhe mundësitë e qytetit tonë, zhvillimi i të cilit do të përmirësojë cilësinë e jetës për të gjithë në komunitetin tonë.

Ai është vazhdim i procesit të planifikimit dhe zhvillimit të programit që synon gjetjen e zgjidhjeve të problemeve me të cilat përballet komuniteti ynë. Me anë të strategjisë aktuale, qyteti do të krijojë një bashkëpunim të përshtatshëm mes komunitetit, biznesit dhe qeverisë vendore, duke i ftuar të gjithë për të bashkëbiseduar për zhvillimin dhe përmirësimin e këtij materiali, në mënyrë që t'i përshtatet dhe të reflektojë më mirë nevojat e qytetit.

Gjithë ky optimizëm vjen kur shikon se si është zhvilluar ky publikim dhe kur, me anë të tij, parashikon të ardhmen e Beratit.

Fadil NASUFI
Kryetari i bashkisë së Beratit



I. Parathënie

Në kuadër të programit Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA) është hartuar një strategji për Zhvillimin Ekonomik Vendor (ZhEV) të bashkive të ndryshme në Shqipëri. Programi u zbatua në Shqipëri gjatë periudhës 2004–2005 dhe u mbështet financiarisht e tekniki-sht nga Banka Botërore (BB; Departamenti i Zhvillimit Ekonomik Vendor) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (SOROS), nëpërmjet Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Hungari. Në bashkëpunim me organizatën shqiptare Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG) u përgatit një strategji për, dhe në bashkëpunim me secilën nga bashkitë e Beratit, Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës. Qëllimi i këtij programi ishte dhe vazhdon të jetë të zhvillojë plane strategjike të veprimit që do ndikojnë në reformimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor në nivel bashkiak, veçanërisht të sektorit privat.

Metodologjia e zbatuar nga DELTA promovon përmirësimin e mjedisit që mbështet dhe lehtëson zhvillimin e biznesit, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore me grupet e komunitetit në përgjithësi dhe atij të bizneseve vendore në veçanti, në krijimin e vizionit të përbashkët dhe hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Vendor (PSZhEV).

Plani Strategjik, hartuar nga secila bashki, do t'i shërbejë institucionalizimit të bashkëpunimeve private-publike dhe zhvillimit të programeve e projekteve vendore, që do të çojnë në përgatitjen e axhendës për një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë. Nëpërmjet forcimit të institucioneve, infrastrukturës dhe politikave që mbështetin ndërmarrjet private, projektet e përvijuara në PSZhEV do të ndihmojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), rritjen e mundësive vendase për punësim në të njëjtën kohë edhe rritjen e të ardhurave për buxhetin bashkiak.

Korniza e DELTA-s i dha mundësinë kapaciteteve lokale të zhvillohen nëpërmjet rishikimit periodik të procesit të planifikimit ZhEV në mënyrë që të ketë një institucionalizim të qëndrueshëm të këtij procesi pranë qeverive bashkiake.

II. Hyrje

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri, transformimi i ekonomisë vendase nga shumë e centralizuar në një variant të tregut të lirë, si dhe hapja e tregjeve dhe burimeve shqiptare ndaj atyre botërore e veçanërisht atyre evropiane, komunitetet, e veçanërisht ai i biznesit, dhe qeveritë vendore u gjetën para sfidës së ndërtimit të një ekonomie të re vendore dhe një strukture biznesi të aftë për t'ju përshtatur tregut dhe konkurrencës botërore.

Gjatë periudhës së tranzicionit të Shqipërisë, struktura e biznesit ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë si në nivel kombëtar dhe atë vendor. Para periudhës së tranzicionit, ndërmarrjet e mëdha publike dominuan tregun, ndërsa tani ai dominohet nga NVM. Fillimi i procesit të decentralizimit, duke lejuar qeveritë vendore të kenë një influencë më të madhe në klimën e biznesit, në mënyrë të natyrshme afruan interesat e këtyre bizneseve me politikën e qeverisë bashkiake. Çdo ditë e më shumë përgjegjësitë kryesore për ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e rregullave lidhur me mjedisin e biznesit po transferohen nga qeveria qendrore në atë lokale.

Ky transformim i ekonomisë ka sjellë në tavolinën e punës së bashkisë një rol të ri: të udhëheqë procesin e stimulimit të rigjenerimit dhe rritjes ekonomike, duke siguruar përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetës së komunitetit nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të biznesit vendas nga pikëpamja ekonomike dhe konkurruese.

Duke marrë parasysh këtë situatë, komunitetit po i bëhet gjithnjë e më e qartë nevoja për të bërë përpjekje më të madhe për të përcaktuar drejtimit më të rëndësishme të zhvillimit dhe të marketingut të suksesshëm të burimeve tona në mënyrë që të krijohen avantazhe konkurruese që do mbështesin bizneset ekzistuese dhe do të tërheqin biznese të reja. Kjo është e vetmja mënyrë që komuniteti ynë të mund të përdorë në mënyrë inteligjente burimet e tij me qëllim që ta bëjë sistemin e tij ekonomik të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.

Me rëndësi në zhvillimin e tërë këtij procesi ka qenë përfshirja e drejtpërdrejtë e bashkisë në planifikimin e ZhEV në të cilin ajo ka luajtur një rol drejtues, koordinativ dhe nxitës. Procesi u mbështet më tej nga institucionet publike të qytetit, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe partnerët e tjerë nëpërmjet një pune të përbashkët e cila mundësoi krijimin e një vizioni të përbashkët dhe drejtimit më të rëndësishme të përcaktuara për garantimin e një mjedisi të përshtatshëm për ZhEV dhe që përkrah bizneset dhe shton punësimin.



III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë

Iniciativa që mori bashkia jonë për hartimin e PSZhEV është në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor përkrahëse dhe mbështetëse e zhvillimit ekonomik brenda juridiksionit të territorit të saj duke synuar përdorimin në mënyrë sa më efektive dhe efçente të burimeve njerëzore, natyrore, sociale, institucionale, financiare dhe fizike me qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për banorët, bizneset e vizitorët.

Procesi i tranzicionit kërkon ndryshime rrënjësore që duhen bërë për të përshtatur qytetin ndaj tendencave dhe kërkesave të një ZhEV të suksesshëm. Ndërkohë shumëllojshmëria e ekonomisë vendase për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të lirë dhe dinamikat e zhvillimit të saj kërkojnë përshtatjen dhe rivlerësimin e marrëdhënieve ekzistuese mes bashkisë dhe komunitetit për të krijuar sisteme pune dhe struktura bashkëpunimi të cilat do t'i shërbejnë rehabilitimit gradual dhe konsolidimit të vazhdueshëm të një ekonomie të shëndetshme dhe të qëndrueshme në qytetin tonë.

Në këtë situatë të re ku bashkia jonë është e hapur ndaj konkurrencës kombëtare dhe ndërkombëtare për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës, bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimit që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese.

Qeveria vendore ka bërë edhe më parë përpjekje për të gjetur dhe bindur investues që të vinë në komunitetin tonë, por ato kanë qenë shpesh sporadike dhe të pakoordinuara mirë me faktorët e tjerë vendas apo ndonjëherë edhe ato më të largët. Përveç kësaj, përmirësimi i mjedisit vendor nga pikëpamja fizike, e cilësisë së shërbimeve, dhe stimuluesve financiarë që kërkohen për të siguruar që bizneset ekzistuese të vazhdojnë të operojnë dhe bizneset e reja që kërkojnë të operojnë ka qenë i papërshtatshëm për shkak të autoritetit të kufizuar ligjor dhe të kapaciteteve financiare të kufizuara të bashkisë.

Pavarësisht nga këto vështirësi, roli që ajo po luan ka ardhur gjithnjë duke u fuqizuar fillimisht si një vëzhgues i zhvillimeve ekonomike dhe ecurisë së biznesit në një aktor të përfshirë aktivisht në krijimin e hapësirave dhe lehtësirave në mbështetjen direkte të biznesit dhe si gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike dhe punësimit. Eksperienca në zhvillimin e Planit Strategjik tregoi se vetëm qeveria vendore, si autoriteti ku kulmojnë interesat politike dhe jopolitike të grupeve të ndryshme të shoqërisë, mund ta luajnë këtë rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik duke përvetësuar një mentalitet dhe praktika pune të reja, si dhe me anë të ruajtjes së marrëdhënieve me aktorët dhe organizatat që veprojnë në komunitetin e vet.

Komuniteti ynë ka nevojë për një qeverisje vendore të zgjuar, partneritete që funksionojnë dhe një krenari civile dhe ne besojmë se strategjia aktuale ka hedhur themelet për këtë.

IV. Plani Strategjik

Ky është i pari Plan Strategjik për ZhEV që është hartuar për bashkinë tonë dhe ai përfaqëson një përpjekje për të sjellë një ndryshim në mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes, si dhe në procesin e vendimmarrjes.

Shfrytëzimi efektiv i avantazheve ekonomike që zotëron komuniteti ynë, si dhe nxitja e tërheqja e investuesve privatë varet shumë edhe nga cilësia e qeverisjes, shërbimeve që ofrohen, si edhe nga cilësia e politikave vendore që zhvillohen dhe zbatohen. Ato ndikojnë në infrastrukturën e shërbimeve të disponueshme për biznesin si: furnizimi me energji elektrike dhe me ujë, transport, telekomunikacion, menaxhimi i mbetjeve dhe planifikimi urban. Fakti që pjesa më e madhe e bizneseve që operojnë në bashkinë tonë janë mikro, të vogla dhe të mesme, që varen shumë nga cilësia e shërbimeve të ofruara nga qeveria vendore, e bën rolin e mëtejshëm të bashkisë edhe më të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi miqësor që përkrah zhvillimin e biznesit.

Ky Plan Strategjik synon të korrigjojë faktorët që kanë pasur deri tani një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe në cilësinë e qeverisjes vendore, dhe kështu për të reduktuar pengesat dhe uljen e rreziqeve të të bërit biznes këtu. Procesi i planifikimit ndihmoi në vlerësimin e këtyre faktorëve dhe nëpërmjet kësaj procedure u realizua rishikimi aktiv i bazës ekonomike dhe faktorëve të zhvillimit të bashkisë për të krijuar një kuptim më i mirë mbi mundësitë dhe pengesat për rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investuesve. Gjatë këtij procesi, partnerët tanë vlerësuan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), faktorët kyç që nevojiten të adresohen me qëllim që të koordinohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Në formulimin e Planit Strategjik, Komisioni i Planifikimit ka rishikuar burimet njerëzore dhe natyrore të disponueshme, gjendjen ekonomike të qytetit dhe zonës përreth saj, trashëgiminë kulturore dhe historike, avantazhet krahasuese, si dhe atë që komuniteti dëshiron dhe i nevojitet.

Ligji “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverive Lokale”, Nr 8652, datë 31.07.2000, Neni 10/III, thotë se “... bashkitë do të marrin përgjegjësitë për funksionet e mëposhtme ekskluzive të Zhvillimit Ekonomik Vendor ... atë të përgatitjes së programeve për zhvillimin ekonomik lokal” duke e bërë zhvillimin e një plani strategjik një detyrim ligjor të bashkisë.

Plani aktual u përgatit për një periudhë 16 mujore. Ne e kuptojmë se ndryshimet dhe përmirësimet e dëshiruara nuk mund të bëhen brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, drejtuesit e bashkisë, së bashku me aktorët publik dhe privatë, do të përkushtohen në zbatimin e këtij plani afatmesëm dhe duke siguruar burimet e mjaftueshme, që ai të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse ky plan ka shumë të ngjarë të ketë sukses në arritjen e qëllimeve të tij. Plani u miratua nga këshilli bashkiak nëpërmjet Aktit Nr 67 të datës 29 Korrik, 2005.



Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik

PSZheEV i bashkisë tonë synon të ka si qëllim të nxjerrë në pah vizionin dhe qëllimet strategjike për zhvillimin e qytetit, të orientojë dhe konsolidojë përpjekjet e bashkisë dhe komunitetit që të zhvillojë një mjedis mbështetës dhe favorizues për zhvillimin e biznesit në vend.

PSZheEV ynë është krijuar për të adresuar si nevojat e drejtuesve tanë ashtu dhe ato të komunitetit tonë që të përmirësojë cilësinë dhe larmi e punëve që janë të disponueshme, të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët tanë dhe të mjedisit për zhvillimin e biznesit.

Bashkia dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e zhvillimit filloi të zbatonte vizionin duke u përqendruar në qëllimet parësore filozofike që shtrihen pas zhvillimit të PSZheEV-it tonë:

- T'i sigurojë komunitetit dhe qeverisë vendore një dokument orientues në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të rritjes ekonomike;
- Të krijojë një shembull të një procesi strategjik vendimmarrës që përfshin bashkëpunimin mes politikanëve vendas dhe komunitetit të biznesit;
- Të lehtësojë përpjekjet për bashkëpunim mes partnerëve publikë dhe privat për një zhvillim të koordinuar të bashkisë;
- Të krijojë një kornizë vendimmarrëse për çështje të tilla si shërbimet publike, infrastruktura, bashkëpunimi me biznesin;
- Të krijojë një eksperiencë të re dhe vendosjen e një kulture të planifikimit të zhvillimit ekonomik;
- Të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese, sepse ne besojmë se në një komunitet ku bizneset ekzistuese nuk janë të kënaqura, ka pak shanse që të mund të krijohen biznese të reja;
- Të ndikojë në politikat e financimit dhe mbështetjes teknike të qeverisë qendrore dhe agjencie donatorë;
- T'i japë bashkisë sonë autoritetin e duhur drejtues që kërkohet në planifikimin e zhvillimit ekonomik;
- Të mundësojë një qeverisje vendore transparente, efektive dhe që i përgjigjet me profesionalizëm nevojave dhe kërkesave pritshmërive të banorëve dhe vizitorëve.

V. Zhvillimi i Planit Strategjik

Zhvillimi i Planit Strategjik u përfundua sipas metodologjisë së përdorur nga Banka Botërore. Kur përdoret procesi gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik është e rëndësishme të arrihet një marrëveshje përfshirëse ku të ekuilibrohen nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Parimet orientuese

Parimet që orientuan bashkinë dhe Komisionin e Planifikimit në formulimin e Planit Strategjik përfshijnë si më poshtë:

- Suksesi ekonomik balancohet me cilësinë e jetës;
- Rritja ekonomike balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore;
- Bashkia është një faktor kyç në përmirësimin e klimës vendore për investime;
- Bashkëpunimi midis qeverisë bashkiake, bizneseve dhe shoqërisë civile është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikim strategjik është një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në bashki;
- PSZhEV përcakton drejtimet kryesore për zhvillimin ekonomik, por nuk e kontrollon atë;
- Synohet përmirësimi i të gjithë mjedisit të biznesit, dhe jo thjeshtë mbështetja e bizneseve individuale;
- Ruajtja dhe mbështetja e bizneseve ekzistuese është po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, sepse ata sillen si një mjet shumë i mirë marketingu për të përkrahur klimën e biznesit;
- Zhvillimi i punësimit duke përdorur burimet e brendshme është më i rëndësishëm se krijimi i punësimit duke përdorur faktorët e jashtëm;
- Është e rëndësishme vendosja e partneriteteve publike–private në vendimmarrje dhe në përmirësimin e ekonomisë vendore;
- Sektorit privat është gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik.



Metodologjia

Qeveria jonë bashkiake e konsideron PSZhEV si metoda më e mirë dhe sistematike e dobishme për të menaxhuar ndryshimin, për të siguruar konsensusin e komunitetit dhe për të krijuar një vizion të përbashkët për një të ardhme ekonomike më të mirë. Procesi i planifikimit strategjik mundësoi kombinimin e përpjekjeve dhe burimet që do të çojnë në përmirësimin e situatës ekonomike dhe si rezultat, në krijimin e një kornize që synon krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, të balancuar mirë për ekonominë dhe një cilësi të përmirësuar të jetës për qytetarët. Edhe pse përvijuar këtu kaq thjeshtë, kjo metodologji rezultoi të ishte shumë komplekse duke pasur parasysh sasinë e përpjekjeve dhe vendimmarrjen e kërkuar.

Procesi i planifikimit strategjik u shoqërua me aktivitete të ngritjes së kapaciteteve dhe të lehtësimit të procesit. Në funksion të ngritjes së kapaciteteve, DELTA organizoi një udhëtim studimor në Hungari ku u mbajtën tre seminare të shkurtra mbi çështjet e mëposhtme:

- Etapat dhe teknikat për zhvillimin e PSZhEV;
- Strukturat institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e PSZhEV në partneritet me komunitetin;
- Njohja me praktikat më të mira rajonale në PSZhEV;
- Metodologjia e zhvillimit dhe prioritarizimit të projekteve.

Procesi i planifikimit

Baza e një procesi efektiv të planifikimit strategjik qëndron në të kuptuarit e çështjeve më të rëndësishme me të cilat përballohet komuniteti. Çështja e zhvillimit ekonomik duhet të paraqitet si një nga problemet për t'u zgjidhur, një nga nevojat për t'u adresuar dhe një nga mundësitë për t'u përdorur. Procesi që u aplikua këtu mundësoi njësimin e opinionëve dhe zgjedhjeve të qeverisë vendore me ato të biznesit dhe agjencive të tjera përfaqësuese.

Procesi i planifikimit u strukturua të kryhej në 5 faza:

1. Organizimi i përpjekjeve;
2. Vlerësimi i konkurrencës së ekonomisë vendore;
3. Zhvillimi i strategjisë;

4. Zbatimi i strategjisë;

5. Rishqyrtimi i strategjisë.

Gjatë periudhës së procesit të planifikimit ishin konsideruar një numër konsultimesh, vlerësimesh dhe vendimmarrjesh të përbashkëta lidhur me prezantimin dhe prioritetin e çështjeve kyçe për zhvillimin ekonomik.

Aktualisht bashkia ka përfunduar tre fazat e para dhe ka filluar fazën e katërt.

Qasja organizative për hartimin e Planit Strategjik

Qasja organizative që u aplikua ishte e tillë që lejoi në procesin vendimmarrës pjesëmarrjen direkte dhe të institucionalizuar të një grupi të gjerë personash që përfaqësonin komunitetin bashkë me kryetarin e bashkisë, anëtarë të këshillit bashkiak dhe stafin e qeverisë bashkiake. Pjesëmarrja u institucionalizua dhe strukturua nëpërmjet Komisionit të Planifikimit të ZhEV i ngritur dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë. Ekipi i komisionit përbëhej nga specialistë të bashkisë së Beratit, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe institucioneve vendore dhe drejtorive që operojnë në territorin e bashkisë. Në ekip bënin pjesë edhe vullnetarët e Peace Corps.

Roli i komisionit ishte të hartonte e të rishikonte Planin Strategjik, dhe kjo përgjegjësi vazhdon me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Struktura e Komisionit u ndërtua e tillë që mundësoi grupimin e anëtarësisë sipas fushave të zhvillimit dhe të interesit.

Element thelbësor në këtë strukturë ishte dhe mbetet Ekipi Kryesor i kryesuar nga Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (DZhEB) dhe ku komuniteti i biznesit kishte një përfaqësues. Ekipi Kryesor luajti një rol kyç në koordinimin e punës midis anëtarëve të komisionit me partnerët e DELTA dhe me agjencitë dhe organizatat vendore e qendrore, të interesuara dhe të angazhuara në zhvillimin e bashkisë. Ky ekip mori pjesë në të gjitha takimet dhe debatet e organizuara në statet e ndryshme të procesit të përgatitjes së draftit të strategjisë së zhvillimit ekonomik. Grupi kryesor i zgjeruar i ZhEV përbëhej nga personat e mëposhtëm:

Emiljano Zhuleku	Drejtor i Programit të Zhvillimit
Mihal Kolani	Drejtor i Financës
Vladimir Çela	Specialist, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Turizmit
Qebir Isaraj	Specialist, Drejtoria Programit të Zhvillimit
Petraq Picinane	Kryetar i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë



Nikolla Langore	Sekretar i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë
Jonathan Owen	Vullnetar, Peace Corps
Steven Tanghe	Vullnetar, Peace Corps
Etleva Dhima	Specialiste, Drejtoria e Çështjeve Sociale
Valentina Zotka	Drejtoreshë e Zhvillimit Urban
Agim Koxhaj	Drejtor i Koordinimit dhe Zhvillimit; Këshilli i Qarkut
Venetik Çela	Drejtor i Bujqësisë dhe Ushqimit
Armanda Shabani	Specialiste Mjedisi, Prefektura
Mirela Buhuri	Specialiste Mjedisi, Bashkia
Piro Ziu	Drejtor i të Ardhurave, Bashkia
Ymer Kordha	Drejtor i Zyrës Ligjore, Këshilli i Qarkut në Këshillin Bashkiak

Struktura organizative e KZhEB tregohet në figurë në faqen 20.

Grafiku kohor i procesit të përgatitjes së draftit të Planit

Ekipi kryesor i ZhEV u mbledh dyherë në javë dhe diskutoi ecurinë e procesit të përgatitjes së draftit dhe raportimit të Strategjisë mbi detyrat e caktuara për secilin nga anëtarët e ekipit. Ai gjithashtu kreu edhe takime mujore të Komisionit të Planifikimit.

Në këto takime të rregullta, Komisioni i Planifikimit vlerësoi ecurinë e bërë për zhvillimin e Strategjisë, analizoi faktorët që do të krijonin ZhEV bazuar në dokumentet e prodhuara nga agjencitë dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare, dhe bazuar në metodologjinë e prezantuar zhvilloi draftin e Strategjisë “Nga vizioni në projekt”.

Forumi DELTA i kryetarëve të bashkisë

Gjatë zbatimit të programit DELTA, krijimi dhe funksionimi i forumit DELTA i kryetarëve të bashkive ka shërbyer si katalizator në procesin e zbatimit të programit dhe si një forum ku kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e grupit të Zhvillimit Ekonomik Vendor (ZhEV) mund të shkëmbejnë eksperiencat dhe të hartojnë planet e punës. Pesë forume u mbajtën gjatë procesit të planifikimit të ZhEV. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, kryetarët e bashkive ranë dakord së një mjet shumë i rëndësishëm do të ishte krijimi dhe mirëmbajtja e një faqeje interneti për secilën nga pesë bashkitë e përfshira në programin DELTA.

Pjesëmarrja dhe konsultimi


Formulimi i dokumentit të Planit Strategjik ishte synimi kryesor i bashkisë, por ajo pati si qëllim të përfshinte në procesin e planifikimit aktorë të tjerë të cilët do të kishin një rol vendimtar në zhvillimin e strategjisë. Do të ishte e pamundur për qeverinë tonë vendore të realizonte procesin e vetme. Kështu që, ishte e nevojshme që të përfshihej edhe ekspertiza e njerëzve të tjerë nga komuniteti që mund t'i sillnin procesit një gamë të gjerë eksperiencash duke siguruar që individëve më të aftë në komunitet t'u ofrohej mundësia për të paraqitur opinionet dhe preferencat e tyre për të adresuar çështjet më kritike që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin ekonomik vendor.

Në gjithsej, 80 njerëz nga komuniteti morën pjesë në procesin e planifikimit përfshirë përfaqësues të qeverisë lokale, komuniteti i biznesit, bankat, institucionet mësimore, përfshirë ndërmarrjet publike, OJQ-të si dhe qytetarë të tjerë të njohur në komunitet për nivelin e tyre të ekspertizës dhe kontributin në shoqëri.

Qeveria bashkiake bëri një përpjekje të madhe për të mbajtur të angazhuar dhe të fokusuar këtë grup të gjerë aktorësh gjatë gjithë procesit të planifikimit strategjik të cilët dhanë ndihmë të paçmuar në formulimin e draft Planit Strategjik.

Ky grup, i përbërë nga njerëz me një gamë të gjerë interesash, demonstroi një vullnet dhe mirëkuptim të përbashkët. Ata kontribuan me njohuritë dhe eksperiencën e tyre dhe siguruan informacion gjatë procesit të zhvillimit të planit. Zyrtarë të institucioneve në bashki dhe gjetkë, nga qeveria qendrore dhe vendore që ushtronin funksionet e tyre në territorin e bashkisë, ndihmuan në sigurimin e mbështetjes për grupet e palëve të interesuara. Në formimin e strategjisë u demonstrua një përfshirje në rritje e palëve të interesuara.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e njerëzve jashtë qeverisë lokale të cilët kontribuan në procesin e dha Planit Strategjik një pronësi të plotë lokale.



Grupet e Punës në zhvillimin e Planit të ZhEV për Beratin

Komuniteti	Shoqëria civile	Agjencitë publike	Biznesi
Nikollaq Mata Ish-kryetar i bashkisë; Anëtar i Këshillit Bashkiak	Milika Jaho Ish-kryetare e bashkisë; Eksperte, Instituti Urban	Luçi Dollani Drejtor, Zyra e Punës	Nikolla Langore Sekretar, Dhoma e Tregtisë
Jorgji Xhaxha Drejtorja e Marrëdhënieve Publike	Steven Tanghe Vullnetar, Peace Corps	Baftjar Kafexhiu Drejtor, Gjelbërimi i Qytetit	Zylyftar Kaçeli Drejtorja e Tatim Taksave
Asllan Sula Historian	Qamile Gishti Qendra për Zhvillimin e Biznesit	Vladimir Kumaraku Kryetar, Këshilli bashkiak; Drejtor i Spitalit	Piro Ziu Drejtor i Tatim Taksave, Bashki
Yzedin Hima Publicist; Ish-kryetar, Këshilli bashkiak	Petrit Revania Koordinator, GTZ	Aleksandër Bode Drejtor	Irakli Gjika Shefi i Turizmit, Prefektura
Hazbi Shehu Gjeolog	Ajet Nallbani Drejtorja e Monumenteve të Kulturës	Kastriot Dervishi Drejtor, Galeria e Arteve	Seit Guri Specialist, Zyra e Taksave
Balil Gjini Drejtor, Biblioteka bashkiake	Fatos Zotka Ish-kryetar, Këshilli Bashkiak	Fatmir Shehu Drejtor, NUK	Maks Çuedari Biznesmen
Dragush Polovina Inxhinier ndërtimi	Vladimir Ela OJQ "AKSI"	Ali Qaseja Sekretar, Prefektura	Eduart Bega Ndërtues
Ymer Kordha Anëtar, Këshilli bashkiak, qarkut Drejtor, Zyra Juridike	Gentiana Deçolli OJQ	Faik Shosha Drejtor, Shëndeti Publik	Kristaq Dollani Biznesmen
Jan Ikonomi Arkitekt	Julejda Gerxhi Jurist	Shpëtim Dyrmishi Drejtor, Qendra e Kulturës	Naun Shtrepi Drejtor, Stacion lokal TV
Kristaq Kolani Inxhinier elektrik; Anëtar, Këshilli Bashkiak	Eglantina Shtrepi Drejtor, Qendra Handicap	Memsur Hoxha Drejtor, Agjencia e Sigurimeve Shoqërore	Gëzim Dervishi Biznesmen
Gora Zaimi Drejtor i Administratës, Bashki	Valentina Zotkaj Drejtor i Zyrës Urbane, Bashki	Armanda Shabani Specialist, Prefektura	Tomor Reovica Biznesmen



Komuniteti	Shoqëria civile	Agjencitë publike	Biznesi
Dionis Papa Historian	Zylyftar Plaku Drejtor, Gazeta lokale	Agim Koxhai Specialist, Këshilli i Qarkut	Sali Hoxha Biznesmen
Tahir Hysi Drejtor, Zyra Urbane, Këshilli i Qarkut	Etleva Dhima Punonjëse sociale	Harilla Ceka Drejtor, Shkolla “BD Karbunara”	Astrit Qafa Ndërtues
Redin KUSTA Inxhinier Ndërtimi			

Procesi i miratimit të Strategjisë së ZhEV

Janë mbajtur disa takime konsultative të Strategjisë së ZhEV me pjesëmarrjen e një publiku të gjerë në Prill, Qershor dhe Shtator 2004. Pjesëmarrësit në takime diskutuan dhe debatuan Strategjinë, moton, qëllimet, objektivat, programet dhe projektet e saj.

Drafti i parë i Strategjisë u përgatit në Nëntor 2004. Përpara se të paraqitej për miratim nga këshilli bashkiak, fillimisht ekipi kryesor i ZhEV e paraqiti draftin përfundimtar për ta rishikuar dhe miratuar nga Komisioni i Planifikimit.

Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore

Gjendja aktuale e ekonomisë vendore të Beratit ishte baza e një analize SWOT (Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet) e cila mori parasysh të dhënat bazë ekonomike si dhe perceptimet vendore të shprehura në një sondazh biznesi si dhe ato të Komisionit të Planifikimit.

Të dhënat e mbledhura përmbanin statistikën dhe informacionet në lidhje me burimet lokale natyrore, njerëzore dhe financiare, strukturën e ekonomisë dhe biznesit, nivelin dhe strukturën e punësimit, nivelin dhe llojshmërinë e arsimit dhe kualifikimit të fuqisë së aftë për punë.

Faktorët kryesorë që u konsideruan si me influence negative në të ardhmen e ZhEV ishin:

1. Zhvillimi i pakontrolluar urban;
2. Papunësia, aktualisht në 18 për qind;
3. Strehimi: aktualisht janë 1,236 familje të pastrehuara që jetojnë në qytet;
4. Infrastruktura e dobët;
5. Aktiviteti i ndaluar industrial;

6. Aktivët e painventarizuar, duke e pasur kështu të pamundur të hyjnë në treg;
7. Largimi i vazhdueshëm i bizneseve nga qyteti;
8. Emigrimi gjithnjë e në rritje i forcës së specializuar të punës;
9. Situata problematike sociale.

Perceptimi i bizneseve

Qeveritë vendore kanë mandatin e promovimit të zhvillimit të NVM vendase. Megjithatë, ky mandat konsiderohet nga sektori privat si i kufizuar ligjërisht sidomos përsa i përket sigurimit të burimeve për ndërmarrjen e aktiviteteve të biznesit.

Për të hyrë pak më thellë në këtë çështje dhe për të kuptuar shqetësimet e biznesit vendas më në detaje, në qytet u krye një sondazh. Qëllimi i sondazhit ishte mbledhja e informacionit dhe e pikëpamjeve të komunitetit të biznesit mbi situatën ekonomike në vend, perspektivën e të bërit biznes këtu, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendase, politikat dhe praktikrat që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe kërkesat e nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit.

Studimi mbi “Klimën e Biznesit” u krye gjatë muajve Mars dhe Prill 2004 dhe morën pjesë **58 biznese** nga kategori të ndryshme.

Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveritë vendore nuk kanë mjetet e duhura ose autoritetin e duhur për të ndihmuar zhvillimin e NVM. Ky perceptim del në pah nga mungesa e komunikimit dhe dialogu i varfër midis qeverisë vendore dhe biznesit.

Përfshirja e opinionëve të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një hap i rëndësishëm në hapjen e procesit të vendimmarrjes. Nëpërmjet këtij hapi, u shqyrtuan opinionet e një grupi njerëzish që kanë influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik të bashkisë.

Pesëdhjetetë biznese, që përbënin pak më shumë se rreth pesë për qind të 1,130 bizneseve të regjistruara në bashki gjatë kohës që u zhvillua sondazhi, ishin në qendër të sondazhit. Dymbëdhjetë nga këto biznese merreshin me prodhim, dymbëdhjetë me tregti, 26 me sigurimin e shërbimeve dhe tetë me ndërtim. Këto biznese kishin qenë aktive për një periudhë nga dy deri në dymbëdhjetë vjet dhe shumë prej tyre për një periudhë nga gjashtë deri në dhjetë vjet. Nga të intervistuarit, 44 ishin pronarë, pesë ishin drejtorë ekzekutivë, dhe nëntë drejtues të lartë. Njëzetë e një nga bizneset kishin një pronar dhe 35 kishin me shumë se një. Një ishte kooperativë dhe një ndërmarrje publike. Pjesa më e madhe, 35, kishin më pak se pesë punonjës, trembëdhjetë kishin nga gjashtë në dhjetë punonjës dhe tetë kishin 11 deri në 50 punonjës dhe dy më shumë se 50 punonjës.



Vizioni dhe Qëllimet

Vizioni

Qëllimi i përcaktimit të vizionit për zhvillimin tonë ekonomik vendor ishte që t'i mundësonte komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur atje. Vizioni do t'u japë qytetarë ve dhe qeverisë vendore një ide të qartë se çfarë duhet bërë dhe ku duhen përqendruar energjitë dhe burimet e tyre.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit dhe pasi u prezantua publikisht nëpërmjet mediave lokale. Synimi ishte të krijohet një vizion i cili të mund të zhvillohet dhe të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi të mundshëm dhe që do të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të ardhmes së preferuar ekonomike të qytetit tonë.

Një vizion në këtë kontekst, është një ideal i cili i ka rrënjët në realitetin natyror, gjeografik, ekonomik, historik e kulturor të rajonit. Ai synon të përmbushë pritshmëritë dhe aspiratat e komunitetit dhe të përcaktojë një drejtim të qartë për zhvillimin e qytetit. Ne besojmë se në rastin tonë ai përmbledh në mënyrë realiste dëshirat dhe kapacitetet e komunitetit tonë. Ne synojmë që këtë vizion ta ndajmë në vazhdimësi me grupe të komunitetit tonë në mënyrë që ai të njihet dhe të pranohet më gjerë dhe kështu, të kthehet në një udhërrëfyes për ta bërë realitet këtë ideal.

Vizioni ynë do të rivlerësohet nga komuniteti, duke përfshirë vendimmarrësit në qeverinë vendore për të reflektuar ndonjë ndryshim të nevojshëm, dëshirat dhe rrethanat e reja, si dhe vlerësimet fundit.

Qëllimet

Përcaktimi i qëllimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga qëllimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet bashkiake. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete ku nuk ofrohen nivele dhe cilësi e përshtatshme e infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.

Për të arritur qëllimet e ZhEV, qyteti ynë është përqendruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e qëllimeve, Komisioni i Planifikimit mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkia, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të rajonit.

VIZIONI

Berati, qytet i bardhë me zemra të bardha, do të jetë një qytet me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, qendra e vetme e turizmit historiko-kulturor e familjar me agrobiznes/biznes agrar e artizanat të konsoliduar

Qëllimi 1:

Zhvillimi i agrobiznesit dhe i NVM përkatëse nëpërmjet shfrytëzimit dhe mitëpërdorimit të potencialeve në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit

Qëllimi 2:

Zhvillimi i turizmit nëpërmjet shfrytëzimit të pasurive historiko-kulturore vetëm të Beratit

Qëllimi 3:

Zhvillimi në qytetin e Beratit i mjedisit urban, në përputhje me parametrat bashkëkohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit



Qëllimet e ZhEV shprehin drejtimet kryesore që do të ndjekë zhvillimi i bashkisë. Këto janë renditur në faqen tjetër sipas rëndësisë për ZhEV dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm. Ato janë zhvilluar me anën e një analize logjike të kujdesshme të vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e qytetit.

Përfitimet e pritshme

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik janë të shumëfishta, por më kryesoret janë si më poshtë:

- Orientimi i këshillit bashkiak dhe administratës së bashkisë në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshirë në PSZhEV;
- Fokusimi tek burimet njerëzore dhe financiare në fushat e identifikuara duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PSZhEV;
- Fuqizimi i partneritetit të qëndrueshëm në vendimmarrje me bashkëfinancim të qeverisë vendore dhe komunitetit të biznesit;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë dhe veçanërisht të DZhEB;
- Koordinimin e aktiviteteve të organizatave dhe agjencive të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e pjesëve të ndryshme të PSZhEV;
- Përcaktimi i një kalendari realist për zbatimin e PSZhEV;
- Identifikimi i rezultateve të pritshme;
- Zhvillimin e një sistemi eficient komunikimi mes bashkisë dhe partnerëve të saj;
- Lehtësimin e marketingut të potencialeve dhe të mundësive që të bëhet biznes në qytet;
- Krijimin e një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin të rezultateve të parashikuara nga PSZhEV;
- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit në bashki në funksion të zbatimit të programeve të përfshira në matricën e Planit;
- Orientimin e grupimit dhe të negocimit me aktorët vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë që janë të interesuar ose që janë përfshirë në projekte në PSZhEV;
- Orientimin e qeverisë vendore dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqendrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme.

Zbatimi i Planit

Një PSZhEV është plani zyrtar për administrimin e qeverisë vendore, institucioneve dhe ndërmarrjeve që ka nën kontroll dhe si i tillë, është një plan që zhvillohet vazhdimisht. PSZhEV për qytetin tonë ka filluar dhe do të ndjekë katër faza:

1. Aktivizimi i burimeve të financimit dhe dhënia e fondeve;
2. Realizimi i partneriteteve publiko-private;
3. Monitorimi dhe vlerësimi i Planit;
4. Rivlerësimi dhe përmirësimi i Planit.

Duke qenë se afati i zbatimit të PSZhEV është më i gjatë se mandati politik, sukcesi i zbatimit të strategjisë do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë vendore dhe shoqërisë civile në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.

Këshilli bashkiak, si faktori kyç në mbështetjen e PSZhEV, do të garantojë dhënien e fondeve bashkiake për financimin e projekteve. Përveç kësaj, ai do të ofrojë këshilla efektive për miratimin e përmirësimeve që do të sugjerohen nga Komisioni i Planifikimit dhe autoriteti ekzekutiv i qeverisë bashkiake.

Kryetari i bashkisë dhe Shefi i DZhEB do të koordinojnë programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatat vendase dhe të huaja në mënyrë që ato të ndjekin dhe mbështesin PSZhEV. Përveç kësaj, ata do të iniciojnë dhe do të realizojnë përmirësimet e mjaftueshme në menaxhimin e procesit dhe do të ristrukturojnë stafin në funksion të zbatimit të PSZhEV. Sukcesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e përfshira në Planin Strategjik do të menaxhojnë elementët veçantë për të cilat ata janë përgjegjës.

Ndërkohë që komuniteti do të njohë progres me zbatimin e PSZhEV, vetë plani do të ketë nevojë të rishikohet, vlerësohet dhe përmirësohet për të adresuar situatat dhe kushtet e reja. Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e Planit duke mbajtur në mendje faktin se edhe komuniteti duhet të marrë pjesë në procesin e monitorimit.

Qasja organizative për zbatimin e Planit

Bashkia caktoi KZhEB si institucionin kryesor që do të rishikojë dhe vlerësojë procesin e zbatimit të Planit Strategjik. Çdo katër muaj KZhEB do të mblidhet për të diskutuar ecurinë e zbatimit të Planit bazuar në raportet e përgatitura nga DZhEB. Ai, çdo vit në muajin gusht, do të diskutojë dhe miratojë



gjetjet, vlerësimet dhe do të shtojë sugjerimet për përmirësime të cilat do t'i paraqiten kryetarit të bashkisë e më pas këshillit bashkiak për diskutim e miratim.

Përbërja e komisionit mund të ndryshoje. Megjithatë, funksionet e tij do të mbesin të njëjta: mbështetje, monitorim dhe rishikim i zbatimit të Planit. Ndërkohë, kryetari i bashkisë në konsultim me KZhEB, mund të emërojë grupe pune për të ndihmuar këtë të fundit në zbatimin e pjesëve të veçanta.

KZhEB do të zhvillojë dhe miratojë një plan pune vjetor për rishikimin e Planit Strategjik. Fondet për veprimtarinë e saj do të miratohen nga këshilli bashkiak mbi bazën e kërkesës së kryetarit të bashkisë.

DZhEB është struktura direkt përgjegjëse për të ndjekur procesin e zbatimit të planit, dhe kryesisht:

- do të sigurojë logjistikën e nevojshme administrative për aktivitetin e Komisionit të Planifikimit,
- do të koordinojë aktivitetet e aktorëve të identifikuar në Plan dhe të atyre që do të përfshihen më vonë;
- do të sigurojë personel për grupet e punës që do të punojnë pranë Komisionit të Planifikimit;
- do të përgatisë dhe paraqesë para kryetarit të bashkisë dhe Komisionit të Planifikimit raportet mbi përmbushjen e procesit të zbatimit të planit;
- do të sigurojë të dhëna dhe informacione që kërkohen nga kryetari i bashkisë dhe Komisioni i Planifikimit.

Financimi i Planit Strategjik

Financimi i zbatimit të Planit Strategjik përbën një përpjekje të madhe për bashkinë po aq sa edhe hartimi i tij. Matrica e Zbatimit të Planit (Kapitulli VIIIc) identifikon kostot e përlllogaritura dhe paraqet partnerët aktualë potencialë. Aktualisht kostoja e zbatimit të Planit llogaritet në 2,721,975,000 Lekë, baraz me 21,775,800 Euro.

Qeveria bashkiake do të financojë Planin Strategjik nga buxheti i saj dhe ky ka filluar tashmë në vitin 2005. Këshilli bashkiak do të vazhdojë të përfshijë zbatimin e programeve dhe projekteve të Planit në buxhetet vjetore dhe afatmesme të bashkisë.

Plani Strategjik do të bashkëfinancohet nga qeveria qendrore, komuniteti i biznesit dhe grupe të tjera të komunitetit, donatorë e organizata vendase dhe të huaja. Angazhimi me investime direkte të komunitetit të biznesit ofron një garanci financiare më shumë në zbatimin dhe suksesin e tij.

VI. Vështrim i përgjithshëm i komunitetit të Beratit

Bashkia e Beratit (40.43V, 19.46L) ndodhet në Shqipërinë jugqendrore, në qarkun e Beratit, që ka një sipërfaqe prej 939 km² dhe rrethohet nga qarku i Skraparit (në lindje), i Përmetit (juglindje), i Tepelenës (jug), i Mallakastrës dhe Fierit (perëndim), i Lushnjës, Kuçovës dhe Elbasanit (veri) dhe i Gramshit (verilindje).

Berat është qendra e qarkut dhe e prefekturës, dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 22.8 km². ajo shtrihet nga 58 dhe 240 metra mbi nivelin e detit dhe është e pozicionuar mes një terreni kodrinor dhe malor me një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej 455 metrash. Berati shtrihet pranë lumit Osum, i vetmi lum pranë qytetit. Burimi i lumit është në malet e Vithkuqit rreth 1,050 m mbi nivelin e detit. Prurja ujore mesatare vjetore varion nga 5.11 m³/sek dhe 74.1 m³/sek. Janë dy male që ndodhen pranë qytetit: Tomori i lartë 2,416 m dhe Shpiragu, 1,218 m.

Klima

Rajoni përreth qytetit ka klimë tipike mesdhetare, edhe pse duke iu referuar variacioneve topografike ka edhe disa mikroklima, si ajo alpine. Muaji më i thatë është Korriku, kurse më të lagështit janë Nëntori dhe Dhjetori. Mikroklimat menjëherë përreth qytetit janë shumë të favorshme për bujqësinë, dhe kështu zhvillimi i biznesit agrar vendas shihet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të qytetit.

Historiku

Berati është një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë dhe ka një trashëgimi kulturore unike. Në shekullin e XVII qyteti ishte krijuar tashmë si një qendër e zhvilluar tregtare. Në shekullin tjetër, Berati e konsolidoi pozicionin e tij tregtar duke vendosur lidhje me Venecian, Triesten, Raguzën, Ankonën, Korfuzin, Maltën, Aleksandrinë, Smirnën, Selanikun, Stambollin, Sofian, Nishin dhe Beogradin.

Në atë kohë, Berati ishte një nga qytetet më të zhvilluara ekonomike dhe kulturore në vend. Ai është i dëgjuar për ndërtesat e bukura të tij arkitekturore. Në fund të viteve 1830, qyteti kishte 8,000 banorë. Ai ruajti karakterin e tij për të pasur një ekonomi të vogël artizanale, dhe kështu filluan të ndërtoheshin punishtet e prodhimit.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, Berati vinte i dyti pas Shkodrës për nga pushteti ekonomik të tregtarëve të mëdhenj, për pronarët e kapitalit tregtar dhe monetar të cilët kishin agjentët e tyre në Durrës dhe Vlorë, si edhe në vendet e tjera në Trieste, Korfuz dhe Maltë. Punishtet e tyre kishin nga pesë deri dhjetë punonjës. Nga 1842 deri në 1888 numri i punishteve artizanale dyqaneve tregtare në Berat u rrit nga 680 në 820. Në fillim të shekullit të XX qelshet prodhoheshin ende në shtëpitë e Beratit.



Në kohën kur u shpall pavarësia, një pjesë e madhe e tokave feudale, rreth 140,000 ha, zotërohej nga pronarë privatë. Rreth 72,000 ha iu përkisnin familjeve dhe rreth 68,000 ha iu përkisnin pronarëve të vegjël. Që nga viti 1912 deri në mes të shekullit të XX, kishte ende tre tregje të mëdhenj në Berat: tregu misrit, tregu i bulmetit dhe tregu i gjësë së gjallë. Më 1961, Berati u shpall Qytet Muze.

Demografia

Vitet e fundit në Berat kanë ndodhur ndryshime të mëdha demografike (shih tabelën mëposhtë). Ndërmjet viteve 1830 dhe 1945 madhësia e popullsisë u rrit pak më shumë se 10 për qind, por më 1980 kishte shkuar më shumë se katër herë, që atë herë ajo është pothuajse dyfishuar përsëri. Që nga 1989, madhësia e popullsisë është rritur me 50 për qind, me ndryshimin më të madh të ndodhur në tre vitet e para pas rënies së komunizmit.

Ndryshimet në madhësinë e popullsisë së bashkësisë

Viti	Numri i banorëve
1945	9,000
1980	34,517
1985	38,500
1989	42,900
1994	61,075
1997	62,749
2000	63,242
2002	64,771
2003	64,833
2004	64,473

Burimi: Bashkia e Beratit

Me interes paraqitet numri i fëmijëve të regjistruar në qytet i cili ka ndryshuar shumë që nga 1989 (shih tabelën më poshtë).

Ndryshimi në numrin e fëmijëve

Viti	Numri i fëmijëve	Viti	Numri i fëmijëve
1955	4,266	1998	16,622
1975	9,485	2002	16,959
1989	16,287	2003	16,823
1994	16,500	2004	16,347
1997	16,553		


Burimi: Bashkia e Beratit

Burimet njerëzore të disponueshme në Berat e pozicionojnë tani qytetin si një burim të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik për Shqipërinë si e tërë. Tabela më poshtë paraqet strukturën moshore të popullsisë së qytetit, duke treguar se shumica është në moshën e punës dhe prezencën e një popullsie të madhe rinore, ndërsa shifrat që pasojnë tregojnë shpërndarjen e madhësisë së familjes në popullsi.

Struktura e moshës së popullsisë

Kategori	Moshë (Vitet)			Gjithsej
	0–14	15–64	65+	
Bashki	16,347	43,407	4,719	64,473
Zona 1	5,696	15,129	1,644	22,471
Zona 2	5,980	15,880	1,727	23,587
Zona 3	3,422	9,087	988	13,497
Zona 4	1,247	3,311	360	4,918

Burimi: Bashkia e Beratit



Burimi: Bashkia e Beratit

Berati ka një popullsi shumë të dendur, me dendësi në rajon si e tërë 2,844 banorë për km², krahasuar me shifrën 10,807 banorë për km² brenda vetë qytetit. Përsëri kjo tregon prezencën e një force të madhe pune të gatshme të disponueshme për qytetin.

Qeveria bashkiake

Bashkia e Beratit bën pjesë në qarkun me të njëjtin emër dhe është qendra e qarkut të Beratit. Këshilli bashkiak, si organi vendimmarrës i qeverisë bashkiake, ka 35 anëtarë, të cilët u zgjedhën për herë të fundit në Tetor 2003. Kryetari i bashkisë zgjidhet direkt nga votuesit.



Administrata bashkiake përfshin 98 punonjës që punojnë në zyrat e bashkisë së qytetit. Nga këta, 51 kanë arsim të lartë dhe 41 të mesëm.

Buxheti i bashkisë

Burimet kryesore të të ardhurave për bashkinë buxhetohen si nga qeveria qendrore dhe ajo vendore; i pari është shumë i rëndësishëm dhe ndahet në fond të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar.

Përmbledhje e buxhetit bashkiak (mijë lekë)

Përshkrim	2003	2004
Të ardhura nga qeveria vendore	182,876	214,251
Nga taksat	96,489	117,428
Grante	61,000	62,000
Shpenzime të qeverisë vendore	475,843	534,033
Nga buxheti i pakushtëzuar	208,286	206,999
Nga buxheti i kushtëzuar	267,557	327,034

Burimi: Drejtoria e Financës, bashkia e Beratit

Investimet e bëra nga buxheti bashkiak më 2004 përfshijnë rreth 29 për qind të investimeve gjithsej në qytet, ndërsa më 2003 ky numër ishte 25.5 për qind. Kompletimi i projekteve aktuale të investimeve do të rritë numrin e investimeve për banor nga 1,419 lekë në 2003 deri në 3,795 lekë në 2004, një rritje me dy herë e gjysëm të investimit për një periudhë një vjeçare. Nga shifrat e 2003, 411 lekë vijnë nga buxheti i qytetit, ndërsa për 2004, kjo shifër qëndron në afro 1,000 lekë.

Qeveria vendore, përveç investimeve të bëra për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit, ka caktuar një prioritet të veçantë për përbormin e të ardhurave të saj për përfitim direkt të qytetarëve të saj me anë të shërbimeve direkte të ofruara për komunitetin.



Pasqyra e përgjithshme e të ardhurave për 2003 dhe 2004 (mijë lekë)

Burimi i të ardhurës	Aktuale 2003	Planifikuar 2004	Aktuale 2004
Tatimi			
Taksë ndërtimi	10,206	10,504	10,397
Taksë e tokës bujqësore	30	1,554	528
Taksa e biznesit të vogël			
Taksë vendore për biznesin e vogël	22,356	28,195	23,029
Taksë e thjeshtuar mbi biznesin e vogël	33,964	41,100	55,907
Taksë regjistrimi vjetore për mjetet e transportit	9,146	9,700	8,891
Taksë për përdorimin e vendit të tregtimit	5,752	7,129	6,464
Taksë për akomodimin në hotel	58	100	82
Taksë për ndikimin e ndërtimeve të reja në infrastrukturë	8,659	16,500	3,759
Taksë mbi ndryshimet në pronësinë e pasurive të patundshme	817	900	3,339
Taksë për tavolinat e restorantit	594	600	622
Taksë therje bagëtish	136	200	34
Taksë reklamimi	306	507	519
Taksë për regjistrimin e biznesit	3,016	1,940	2,093
Nëntotali	96,489	120,149	117,428
Sistemi jotatimor			
Tarifat e pastrimit	14,290	18,580	18,386
E drejta për të përdorur pronën publike (qera ndërtese)	208	208	167
Liçensë autorizimi, etj (liçensë transporti)	808	1,475	1,611
Të ardhura të tjera			
a) shitje trualli	0	1,300	196
b) qera	0	660	3,142
c) aktivitet ekonomik (të ardhura nga biletat)	51	60	35
d) të tjera	1,082	1,000	1,031
Pagesa nga			
Prindërit, për ushqim për fëmijët e shkollës	7,198	7,200	7,604
Prindërit, qendrat e kujdesit ditor (çerdhe)	1,100	2,500	2,455
Prindërit, për drekën e kopshtit	603	100	98
Të tjera	47	0	99
Nëntotali	25,387	33,083	34,823
Gjithsej	121,876	153,232	152,251

Burimi: Drejtoria e Financës, bashkia e Beratit


VII. Profili ekonomik i Beratit

Ashtu si dhe ekonomia e vendit si e tërë, edhe ekonomia e Beratit është në tranzicion. Si e tillë, ajo bart të gjitha vështirësitë si edhe përftimet që e pasojnë këtë tranzicion. Sfida më e madhe është kalimi nga ndjenjat e dëshirës së madhe dhe besimit në zbatimin dhe rezultatet.

Bizneset vendore, veçanërisht prodhuese, duan të zhvillohen dhe të zgjerohen duke përdorur burimet rajonale natyrore dhe avantazhet gjeografike me efektivitet dhe efikasitet të madhe. Bizneset me bazë turizmin shfrytëzojnë trashëgiminë historike dhe arkitekturore të qytetit. Bizneset e zejtarisë, edhe pse të vogla dhe të mbështetura tek familja, duan t'i mbajnë gjallë traditat dhe madje t'i zgjerojnë ato në nivel kombëtar dhe mundësisht në tregjet ndërkombëtare.

Ndërkohë, bizneset tregtare po e riformojnë profilin e tyre, duke u shkrirë me prodhimin vendas.

Sipas statistikave, karakteristika kryesore e ZhEV është një ndarje spektrale e ekonomisë private. Baza kryesore në të cilin mbështetet ky zhvillim është, përveç traditës dhe faktorëve të tjerë të sipërpërmendur, zgjerimi nga biznes i vogël në të mesëm dhe të madh, si dhe ndryshimi në strukturën e biznesit, duke u përqëndruar në Berat kryesisht në bizneset agrare, hotele, turizëm dhe shërbime.





Përparësitë kryesore të bashkisë së Beratit

Berati ka një pozitë të favorshme gjeografike për vendosjen e një infrastrukture moderne, complete. Pozita e tij, flora dhe fauna, si edhe arkitektura dhe artefaktet e bëjnë qytetin tërheqës për turistët dhe të përshtatshëm për zhvillimin e një jete me cilësi të mirë për qytetarët e tij.

Rajoni ka një klimë tipike mesdhetare, që e bën të mundur zhvillimin e bujqësisë si një bazë të rëndësishme për zhvillimin e agrobiznesit. Sipërfaqja e përgjithshme prej afro 23 km², nga të cilat rreth gjashtë km² janë urbane dhe rreth dy km² janë tokë bujqësore, mbështet idenë e zhvillimit të bujqësisë vendase. Përveç kësaj, sistemi ujitë s së tokave është ende funksional, kë shtu që një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës bujqësore është tashmë në vend.

Lagja e Uznovës në Berat është ndarja më e re administrative e bashkisë dhe përfshin një sasi të konsiderueshme të tokës bujqësore. Ajo ofron shumë mundësi për zhvillimin e bujqësisë, me zgjerimin e fermave si rezultat i afërsisë së fshatrave dhe komunave me qytetin.

Berati është shtëpia e muzeumeve dhe artefakteve kulturore të panumërta, që së bashku kanë një vlerë unike, duke e bërë qytetin tërheqës si për turistët vendas dhe ata të huaj. Në qytet ka rreth 108 monumente kulturore dhe lagja e Mangalemit është shtëpia e një kompleksi unikal të muzeumeve të arkitekturës së jashtë zakonshme. Lagja e “një mijë dritareve” ka një mijë e një mundësi për turistët e huaj, kombëtarë dhe vendas. Lagja e kalasë ka shumë objekte të rëndësishme kulturore, që përfshijnë që nga 1961, muzeumin e Onufrit, ndërsa arkitektura unike e lagjes ka tërhequr vëmendjen si të kërkuesve vendas dhe të huaj. Lagja “Gorricë” është një tjetër muzeum kompleks, përsëri me një rëndësi arkitekturore, duke qenë pjesë e pasurisë natyrore dhe historike të qytetit që tërheq si vizitorët vendas dhe ata të huaj.

Popullsia e qytetit është relativisht e re, me një moshë mesatare 28 vjeç dhe me një jetë gjatë si prej 70 vjeç. Kështu, ai ka një fuqi punë tore të gatshme, të re, që duke marrë parasysh rëndësinë dhe cilësinë e arsimit në Berat, është edhe e kualifikuar mirë. Përmirësimi i mëtejshëm i arsimit profesional dhe të përgjithshëm, duke u marrë me disa mangësi, do të përmirësojë kualifikimet e kësaj force pune.

Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve dhe infrastrukturës bashkiake është një tipar i rëndësishëm që hap një perspektivë të re për të ardhmen e zhvillimit ekonomik të Beratit, ndërsa situatë e favorshme për sa i përket ligjit dhe rendit siguron një mjedis të sigurtë investimi për biznesin.

Rrotull qytetit, ka një hapësirë të përshtatshme për zgjerimin e përqendrimit të bizneseve brenda zonës ekzistuese industriale dhe për përmirësimin e zonës së fabrikës së baterive me qëllim që ai të behet një vend i rëndësishëm zhvillimin e agrobiznesit. Pozicioni i zonës e bën atë një sipërfaqe të përshtatshme për ngritjen e një tregu me shumicë për biznesin agrar.

Largësia e qytetit të Beratit nga portet detare, aeroportet dhe qytetet e tjera të vendit nuk është e ndjeshme dhe e bëjnë komunikimin të lehtë.

Bizneset private në qytetin e Beratit

Numri i përgjithshëm i bizneseve që veprojnë në Berat gjatë 2004 ishte 1,144, nga të cilët 1,059 ishin biznese të vogla dhe 85 biznese të mëdha (shih tabelën).

Pasqyra e numrit të bizneseve, Janar deri Qershor 2004

Përshkrimi	Numri	Përqindja
Biznes i vogël		
Pakicë	344	32.5
Shërbim	233	22
Transport pasagjerësh	132	12.5
Ushqimore	140	13.2
Bare	139	13.1
Prodhim	56	5.3
Ambulator	15	1.4
Nëntotali	1,059	93
Biznes i madh		
Ndërtim	27	31.8
Prodhim	17	20
Transport, import-eksport	41	48.2
Nëntotali	85	7
Gjithsej	1,144	100

Numri i bizneseve prodhuese, Janar deri Qershor, 2004

Përshkrimi	Numri	Përqindja
Prodhim i miellit dhe bukës	19	24.7
Duralumin	15	19.5
Pije dhe ushqime të konservuara	14	18.2
Përpunim druri	7	9.1
Konfeksione	7	9.1
Prodhime materialelesh ndërtimi	5	6.5
Përpunim i gurit dhe mermerit	5	6.5
Tekstile	1	1.3
Përpunimi i bimëve mjekësore	1	1.3
Letër	1	1.3
Prodhimi i mishit dhe sallamit	1	1.3
Përpunimi bujqësor	1	1.3
Gjithsej	77	100.1

**Numri dhe sipërfaqja e biznesit të prodhimit, Janar deri Qershor 2004**

Përshkrim	Nr.	Gjithsej (m ²)	Mesatare (m ²)
Materiale ndërtimi	5	13,355	2,671
Industria e letrës	1	2,400	2,400
Gurë dhe mermerë	4	2,900	725
Pije dhe ushqim i konservuar	14	6,659	476
Industria e drurit	7	2,521	360
Të tjera ushqimore	31	5,968	192
Duralumin	15	1,338	89

Agrobiznesi

Agrobiznesi është sektori më i zhvilluar dhe që ende premton shumë për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik në Berat, që reflektohet në numrin e bizneseve të tilla (41) vepruese sot në bashki, përmasat e territorit që zënë këto biznese (23.5 për qind të sipërfaqes), numri i të punësuarve në sektor (42.3 për qind e totalit) dhe raporti (49 për qind) i numrit gjithsej të bizneseve.

Për më tepër, disa produkte bujqësore si ullinjtë, fiqtë dhe qershitë janë kultivuar në Berat për mijëra vjet me rradhë, duke llogaritur që 13 për qind e sipërfaqes gjithsej bujqësore të bashkisë është e mbjellë me drurë ulliri dhe 6 për qind me drurë fiku dhe qershie. Ka rreth 700,000 drurë ulliri që rriten në 6,000 ha tokë bujqësore të bashkisë, si edhe 151,700 drurë fiku. Vetëm në qytet numërohen rreth 78,000 drurë fiku që prodhojnë rreth 10 kg fiq për pemë.

Gjashtëdhjetë për qind e durëve të ullirit të Beratit janë nga 15 deri 40 vjeçarë, ndërsa 25 për qind janë më shumë se 40 vjeçarë. Ulliri i madh zë 70 për qind të prodhimit të përgjithshëm. Tre karakteristikat kryesore të këtij produkti janë tulli masiv, ngjeshmëria dhe përbërja e vajit, që lejon të ruhen në mënyrë natyrale për një kohë të gjatë cilësitë e frutit.

Sot, industria e agrobiznesit në Berat ende përdor kryesisht prodhimin vendas bujqësor. Dy produktet kryesore ulliri dhe fiku janë me famë në tregjet e huaja. Eksporti i këtyre produkteve përbën një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të përgjithshme të rajonit. Tregu vendas po përmirësohet dhe këto produkte kanë një numër të madh konsumatorësh në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi dhe Fieri. Përpunimi dhe konservimi i ullirit aktualisht numëron 11 për qind të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin e agrobiznesit dhe zë rreth 1,000 m² të zonës industriale (11 për qind të sipërfaqes së përgjithshme), duke përpunuar rreth 550 ton ullinj në vit.

Kjo fushë e prodhimit i ka parë tashmë përmirësimet në cilësinë lëndës së parë dhe teknologji. Cilësia e lëndës së parë, duke u rritur dhe vjelur në mënyrë organike dhe tradicionale, krijon një avantazh të rëndësishëm për produktin.

Qyteti strehon më shumë se gjysmën (57 për qind) e biznesit agrar të rajonit, duke punësuar më shumë se gjysmën e punonjësve (59 për qind). Investimet në këtë sektor gjatë viteve të fundit kanë lehtësuar punën që bëhej, ndërsa teknikat moderne të aplikuara në prodhimin e linjave të ndryshme kanë sjellë prodhimtari të lartë dhe rritje të të ardhurave, që demonstron në kapacitetin prodhues të vendosur dhe në numrin e të punësuarve.

Bizneset agrare të Beratit janë duke u konsoliduar dhe tregjet janë të mbuluara mirë gjeografikisht, si brenda dhe jashtë vendit. Dy shembuj model janë kompanitë “Sidnej” dhe “Dea”, të cilave iu janë dhënë medalje të arta në panaiet ndërkombëtare të tregëtisë.

Statistikat e agrobiznes sipas ndarjes administrative

Përshkrim	Bashkia	Rajoni	Kuçova	Skrapar	Gjithsej
Numri i bizneseve	41	78	22	37	137
Numri i të punësuarve	208	355	52	81	488
Hapësira industriale	9,400 m ²				
Kapaciteti prodhues	10,878 t/vit				

Një përforsim i ngjashëm po ndodh në sektorin e përpunimit të produkteve bujqësore, ku vetëm dy baxho me kapacitet prodhimi prej 1,500 ton në vit (kapaciteti mesatar vjetor i prodhimit), janë aktivë. Deri tani kjo industri është ngritur vetëm me kapital vendas.

Përveç rikonstruksionit të linjave të vjetra të prodhimit dhe përdorimit të mjeteve artizanale të prodhimit, është ndërtuar një fabrikë e re për prodhimin e konservave dhe pijeve (Aleura). Gjithashtu, edhe kantina e verës në kompleksin ushqimor të Beratit është rikonstruktuar dhe është ndërtuar një kompani e re “Sidnej” që prodhon ushqim të konservuar.

Kjo fushë e prodhimit ka një perspektivë të fortë për investime meqenëse konsumatorët kanë besueshmëri në rritje për këto produkte.

Artizanati



Ashtu siç u përmend më lart në këtë dokument, përveç agrobizneseve, artizanati është një tjetër prioritet i zhvillimit ekonomik të Beratit, dhe do të stimulohet me anë të ruajtjes dhe kultivimit të traditës dhe me anë të përfaqësimit të tij në panaiet kombëtare dhe ndërkombëtare të tregëtisë, siç është panairi në Leçe, të Italisë organizuar në fund të 2004.



Bizneset e tjera

Ka shumë biznese të tjera aktivë në Berat që përfshijnë industrinë përpunuese të mishrave të ndryshëm, produkte bulmeti si dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike, ndërsa disa industri prodhuese janë duke u përtërirë dhe po tërheqin investime, si industria e ndriçimit, industria e veshmbathjeve, prodhimi i materialeve të ndërtimit, përpunimi i drurit, etj. (shih shifrat më poshtë).

Struktura e bizneseve të tjerë aktivë në qytetin e Beratit



Përveç linjave të trashëguara dhe artizane të prodhimit, fabrika e përpunimit të ushqimit dhe pijeve “Aleura” në Uznovë, ish-ndërmarrja shtetërore e përpunimit ushqimor, kompania e përpunimit ushqimor “Sidnej”, etj, janë ose ndërtuar ose rindërtuar dhe tani janë në veprim.

Edhe pse niveli aktual i prodhimtarisë është më i ulët se ai në kohën e regjimit komunist, numri i treguesve është përmirësuar.

Prodhimi i materialeve të ndërtimit është duke u riformuar, duke hyrë në tregun ndërkombëtar me materiale të papërpunuara lëndësh të para (p.sh. blloqe guri nga Qafa e Kumbullave), ndërsa disa biznese të vogla po demonstrojnë forcë me anë të kombinimit të mirë të produkteve me traditën. Guri i mirënjohur i Beratit, i prerë dhe i papërpunuar ose i përpunuar, paraqet sot të kaluarën e pasur tradicionale të artizanatit së Beratit.

Mundësitë investuese në këtë sektor, pozita gjeografike e qytetit, burimet e tij natyrore dhe disponueshmëria e një force pune të kualifikuar me kosto të ulët janë faktorë që tregojnë praninë në të ardhmen e një mundësie fitimi të madh për të tërhequr investues, dhe me investimet vjen edhe zhvillimi për të gjithë.

Vizitorët

Ashtu si tregohet edhe në tabelën më poshtë, kanë qenë rreth 2,000 vizitorë në Kalanë e Beratit në pesë javët e para të fillimit të verës më 2004. Gjysma e këtyre turistëve kanë qenë nga Kosova, por dhjetë për qind ishin të huaj të tjerë. Shifrat disponuese për akomodimin dhe shërbimin në restorant duken të jenë të përshtatshme për këtë numër vizitorësh.

Vizitorët në kalanë e Beratit, nga 15 qershor deri në 22 korrik 2004

Origjina	Numri
Kosova	1,000
Vendas të tjerë	400
Shkodra	300
Të huaj të tjerë	209
Gjithsej	1,909

Hotelet dhe restorante

Emri	Dhoma	Shtretër	Vende	Të punësuar
Tomori	53	110	-	-
Gega	25	49	150	13
Berati	9	18	86	10
Castile Park	9	19	148	15
Palma	7	12	150	5
Mangalemi Tomi	7	10	115	4
Belind	5	6	150	4
Ago	7	10	80	3
Mangalemi	3	7	7	-
Desaret	4	8	40	-
Gjithsej	129	249	926	54



Mundësitë e komunikimeve

Infrastruktura aktuale rrugore e lidh fare lehtë Beratin me rrjetin e rrugëve kryesore të vendit, duke lehtësuar lidhjen me portet detare dhe aeroportet e Shqipërisë.

Rrjeti rrugor i qytetit

Gjithsej	265,000 m²
Të asfaltuara	141,000 m ²
Sheshe të asfaltuara	8,000 m ²
Trotuare (Gjithsej)	23,300 m ²

Numri i mjeteve të regjistruara për transportin urban në 2004

Përshkrim	Numri	Përqindje
Vetura	1,993	85.3
Autobus	97	4.2
Furgon	231	9.9
Minifurgon	16	0.7
Gjithsej	2,337	100.1

Telekomunikacioni mundësohet nga Albtelekomi, rrjeti I linjës fikse, dhe nga dy kompani telefonike të lëvizshme (celulare) AMC dhe Vodafon. Numri mesatar i abonentëve për secilin operator, nëse është linjë e lëvizshme ose fikse, është rreth 16,200 për Beratin. Shërbimi ofrohet për rreth 40 për qind të familjeve në qytet, ndërsa 95 për qind e abonentëve janë individë privat. Në Berat ka tri qendra funksionale interneti dhe menaxhohen nga operatorë privat, ndërkohë që edhe Albtelekomi e ofron shërbimin e internetit.

Abonentë të kompanisë së linjës fikse telefonike për 7 muajt e parë të 2004

Përshkrim	Gjithsej	Familja	Biznesi	Institucionet	Të tjerë
Nr. i abonentëve	6,776	6,451	48	156	121
Përqindje	100	95.02	0.07	2.03	1.08

Arsimi

Numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave të mesme në Berat është 3,327, kurse numri i nxënësve të shkollave të mesme profesionale është 1,317 ose rreth 40 për qind e numrit të përgjithshëm.

Në 2001, treguesit e përgjithshëm në lidhje me nivelin e arsimit të arritur nga popullsia ishin: 33 për qind e popullsisë kishte mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme dhe profesionale; 44 për qind kishin

përfunduar shkollën e mesme dhe 6 për qind kishin përfunduar arsimin e pasmesëm. Në bashkinë tonë, ka tri shkolla të mesme profesionale: për inxhinieri mekanike, për inxhinieri elektrike, për agronomë, për mësues, etj, dhe çdo vit nga këto shkolla diplomohen rreth 600 nxënës, por vetëm 12.5 për qind janë të kualifikuar në fushën e agrobiznesit.

Numri i nxënësve dhe institucioneve arsimore nga 1992 deri 2003

Emri	1992	1997	2002	2003
Institucione	39	30	31	29
Nxënës	11,965	10,518	10,571	10,771
Kopshte	21	13	12	12
Fëmijë në kopshte	2,252	1,306	1,604	1,549
Shkolla 9-vjeçare	11	11	11	10
Nxënës	7,557	7,239	5,964	5,857
Shkolla të mesme	6	5	6	
Nxënës të shkollave të mesme	2,156	1,973	3,003	3,327
Fjetore	1	1	2	2
Të strehuar në konvikte	-	-	419	568
Qendra të kujdesit ditor	-	3	3	4
Fëmijë në qendrat e kujdesit ditor	-	69	100	120

Numri i studentëve që filluan dhe përfunduan vitin akademik 2003

Dega	Të regjistruar	Mbaruan
Mësuesi	605	330
Agrobiznes	134	74
E përgjithshme	3,698	1,937
Gjuhë të huaja	67	49
Muzikë	104	66
Mekanike 5-vjeçare	38	21
Mekanike 3-vjeçare	82	42
Elektrike 5-vjeçare	86	42
Elektrike 3-vjeçare	38	17
Hidraulikë	33	

Numrat për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm publik dhe jopublik, 2004

Tipi	Studentë	Mësues	Studentë : mësues
9-vjeçar publik	5,834	326	17.9
I mesëm publik	3,250	185	17.6
I mesëm jopublik	77	9	8.5
I mesëm i përgjithshëm publik	1,933	91	21.2
I mesëm profesional publik	1,317	94	14



Kosto e jetesës

Qeraja në qytet është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga viti 2000, kur qëndronte në vlerat 3,000 deri në 4,500 lekë për një apartament të pamobiluar. Në vitin 2004, qeraja varioante nga 5,000 deri në 6,500 lekë për një apartament. Qeraja e një apartamenti të mobiluar është rritur edhe më shpejt duke dyfishuar madhësinë e rritjes së apartamenteve të pamobiluara. Edhe pse marrja me qera e një apartamenti në Berat është më e lartë se në qytete e tjera rajonale të Shqipërisë, ajo përsëri është ndërmjet një të tretës dhe një të dytës së vlerës së qerasë të paguar në Tiranë dhe Durrës.


Çmimi i tregut të një apartamenti të ri varet nga vendndodhja, duke variuara nga 31,000 lekë/m² në periferi deri në 42,000 lekë/m² në qytet, duke treguar kështu një rritje të çmimeve të vitit 2000. Edhe kostot rënduara të ndërtimit janë rritur që nga viti 2000, kur qëndronte në vlerat nga 20,632 lekë/m² deri në 24,200 lekë/m² në 2004.

Kostoja e ndërtesës për m² ishte 25,502 lekë në vitin 2003 dhe brenda një viti u rrit deri në 28,000 lekë. Të dhënat nga Drejtoria e Zhvillimit Urban tregojnë se gjatë vitit 2003 janë lëshuar shumë pak leje ndërtimi krahasuar me vitin 1999 (shih tabelën më poshtë).


Numri i ndërtesave dhe lejeve të ndërtimit ndërmjet 1999 dhe 2003

Tregues	Viti				
	1999	2000	2001	2002	2003
Zona të miratuara për ndërtim	98	51	39	67	33
Leje ndërtimi të lëshuara	68	51	39	65	28
Leje ndërtimi për banesa	54	25	14	16	6
Përdorimi i lejeve për banesa	34	27	28	18	11
Banesa të filluara gjatë një viti	52	20	12	16	5
Banesa të ndërtuara pa leje			501 ha		
Zgjerimi i vijës së verdhë			74 ha		
Hapësirat publike të pastruara nga ndërtimet e palicënsuara	0 ha	0 ha	0.15 ha	0.3 ha	1.8 ha

Megjithatë, numri i lejeve të lëshuara gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2004 për ndërtesa të reja është rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2003.



Niveli i të ardhurave për shtëpi mund të paraqitet kështu:





VIII. Dokumentet përbërëse të Planit Strategjik

Plani Strategjik përfshin dokumentet e mëposhtme:

- a. SWOT, analiza e konsoliduar
- b. Matricat e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit
- c. Matricat e zbatimit të Planit
- d. Matricat e prioriteteve të projekteve
- e. Fishat e projektit

a. SWOT, analizë konsoliduar

	Të brendshëm	Të jashtëm
Pozitive	<p><u>Pikat e forta</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trashëgimia kulturore dhe historike me potencial për të turizmin 2. Klimë e butë mesdhetare 3. Potencial i qëndrueshëm dhe optimal për zhvillimin e agrobiznesit (prodhim dhe përpunim) 4. Rritje e turizmit familjar, historik dhe kulturor 5. Burimet natyrore sipërfaqësore dhe nëntokësore 6. Nivel i mirë i kualifikimit të forcës së punës 7. Ndërtesat ekzistuese favorizojnë ngritjen e bizneseve të reja (në zonën industriale) 8. Vullneti pozitiv politik qendror dhe vendor për të ndërtuar planet strategjike vendore dhe rajonale 9. Mikpritja: karakteristikë vendase që favorizon zhvillimin e turizmit familjar 10. Qyteti është qendër rajonale 11. Rend i mirë publik 12. Popullsia e re me nivel të mirë të arsimit të përgjithshëm, veçanërisht e fortë në gjuhët e huaja dhe me një dëshirë për të mësuar 	<p><u>Mundësitë</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lehtësi për të arritur në aeroportin e afërt të Kuçovës 2. Burime dhe ide për të përdorur bukuritë natyrore të luginës së lumit Osum për turizmin ekologjik, hapësirat publike, qendrat pushuese, etj 3. Afria me portet e Vlorës dhe Durrësit dhe me aeroportin e Rinasit 4. Prania e bankave: kredi për bizneset 5. Afria (25 km) me malin e Tomorit (2,416m) dhe monumentet e tjera natyrore 6. Mbështetja e zhvillimit të biznesit të suksesshëm dhe në rritje



Negative	<u>Pikat e dobëta</u> <ol style="list-style-type: none">1. Hapa të ngadalshëm të procesit të decentralizimit2. Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike3. Mungesë e një plani të përgjithshëm urban për qytetin4. Mungesa e rrugës unazore të qytetit5. Vonesa në transferimin e pronave publike nën pronësinë e bashkisë6. Nuk ka sistem kredie për mbështetjen e qeverisë vendore7. Mjediset tregtare të organizuara keq	<u>Kërcënimet</u> <ol style="list-style-type: none">1. Migrimi i biznesit2. Emigrimi3. Qeveria vendore dhe institucionet qeveritare mund të mos i koordinojnë përpjekjet për të përdorur mundësitë4. Konkurrenca5. Shkatërrimi i qytetit të vjetër historik dhe arkitekturës së tij unike me anë të ndërtimeve të paligjshme dhe mungesës së financimit6. Largimi i specialistëve të qytetit drejt Tiranës apo jashtë vendit

b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit

VIZIONI:					
Berati, Qytet i Bardhë me Zemra të Bardha, do të jetë një bashki e begatë me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, me agrobiznes e artizanat të konsoliduar dhe qendra e turizmit familjar përqëndruar në historinë dhe kulturën e tij unike					
Qëllimi	Objektivi	Programi	Projekti		
Qëllimi 1: Zhvillimi në rajonin e Beratit i agrobiznesit dhe i NVM përkatëse me anë të përdorimit të përshtatshëm të potencialit në fushën e prodhimit, përpunimit dhe marketingut	Q1:O1: Kthimi i Beratit në qendër rajonale kryesore të grumbullimit e përpunimit të produkteve bujqësore	Q1:O1:PG1: Caktimi i hapësirave të përshtatshme në qytet për vendosjen e bizneseve agrare Q1:O1:PG2: Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në zonat e përshtatshme për biznesin agrar	Q1:O1:PG1:p1: Përgatitja e studimit për integrimin e mjedisëve të bizneseve agrare në planin urban të qytetit Q1:O1:PG1:p2: Përgatitja e studimit për ngritjen në qytet të një parku për biznesin agrar për grumbullimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore të qarkut		
			Q1:O1:PG2:p1: Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku ekzistojnë tashmë bizneset agrare	3	
		Q1:O2: Sigurimi i mbështetjes si për bizneset e reja dhe ato ekzistuese të biznesit agrar në Berat duke koordinuar aktivitetet me palët e interesuara vendase	Q1:O2:PG1: Sigurimi i mbështetjes, lehtësimit të procedurave administrative dhe detyrimeve fiskale, si dhe trajnimi, si dhe mundësimi i informacionit mbi kreditë për NVM të biznesit agrar	Q1:O2:PG1:p1: Ngritja pranë bashkisë e Zyrës së Asistentës “One-Stop-Shop” për të lehtësuar procedurat e bizneseve Q1:O2:PG1:p2: Përgatitja e studimit mbi politikatat fiskale vendore për bujqësinë Q1:O2:PG1:p3: Publikimi i broshurës mbi mundësitë dhe kushtet e kreditimit të biznesit agrar vendor Q1:O2:PG1:p4: Organizimi i seminareve periodike mbi zhvillimet rajonale të biznesit agrar me pjesë marjën e grupeve të lidhura me biznesin dhe institucioneve të interesuara	4 5 6 7
		Q1:O3: Promovimi i produkteve bujqësore të qarkut	Q1:O3:PG1: Ndërmarrja e iniciativave për krijimin e tregjeve të reja për produktet bujqësore të qarkut	Q1:O3:PG1:p1: Ngritja e një shoqate të biznesit agrar Q1:O3:PG1:p2: Organizimi i panairit periodik të produkteve bujqësore Q1:O3:PG1:p3: Publikimi periodik i buletinit bujqësor dhe blegtoral	8 9 10
		Q1:O4: Përmirësimi i kapaciteteve prodhuese dhe i standardeve për produktet bujqësore nga qarku i Beratit	Q1:O4:PG1: Vendosja e standardeve të përbashkëta për produktet bujqësore	Q1:O4:PG1:p1: Përgatitja e një buletini informues mbi standartet bujqësore dhe tendencat e tregut si në rajon dhe jashtë vendit	11



Qëllimi	Objektivi	Programi	Projekti	Nr	
Qëllimi 2: Zhvillimi i turizmit të Beratit duke përdorur trashëgiminë e tij unike historike dhe kulturore	Q2:01: Përfshirja e zonave të qytetit dhe objekteve historike dhe kulturore nën trashëgiminë e mbrojtur të UNESCO	Q2:01:PG1: Plotësimi i kushteve për përfshirjen e objekteve historike dhe kulturore të Beratit nën mbrojtjen e UNESCO	Q2:01:PG1:p1: Përgatitja e dosjes mbi Beratit që do të shërbejë si bazë për përpjekjet e Këshillit të Ministrave për ta përfshirë qytetin në listë n e vendeve me trashëgimi kulturore të UNESCO	12	
	Q2:02: Promovimi i turizmit në qytet me anë të sigurimit të një informacioni të detajuar bashkëkohor	Q2:02:PG1: Koordinimi i përpjekjeve dhe përcaktimi i fushës së veprimit dhe ndarjes së përgjegjësisë mes palëve të interesuara për të promovuar kapacitetin turistik të qytetit	Q2:02:PG1:p1: Hartimi i një plani të përbashkët veprimi mes bashkisë dhe agjencive private dhe shtetërore që vepronin në fushën e turizmit Q2:02:PG1:p2: Ngritja e një strukture bashkëkohore për të mbledhur dhe shpërndarë të dhënat në lidhje me potencialet turistike që ofron qyteti Q2:02:PG1:p3: Ngritja e një Qendre Informacioni për Turistët Q2:02:PG1:p4: Përgatitja dhe shpërndarja e guidës turistike dhe përgatitja e faqes dixhitale (të internetit) për qytetin	13	
	Q2:03: Rikonstruksioni dhe ruajtja e vlerave kulturore dhe historike të Beratit	Q2:03:PG1: Përcaktimi i nevojave dhe mundësive ndërinstitucionale për mbrojtjen dhe rehabilitimin e vlerave kulturore dhe historike të qytetit	Q2:03:PG1:p1: Kryerja e studimit mbi nevojat për rikonstruksion, mirë mbajtje, ruajtje dhe zbulim të artefakteve (objekteve) historike dhe kulturore të Beratit Q2:03:PG1:p2: Organizimi periodik i debeteve në media për të analizuar kushtet e trashëgimisë kulturore të qytetit dhe aktivitetet e agjencive përgjegjëse	14	
	Q2:04: Rritja e standardit të shërbimit në hotele dhe biznese të tjera hoteliere	Q2:04:PG1: Rritja deri në arritjen e standardeve bashkëkohore të nivelit të kapaciteteve dhe të shërbimeve në hotelet e Beratit	Q2:04:PG1:p1: Kryerja e një serie kursesh trajnimit për bizneset dhe agjencitë që vepronin në fushën e turizmit	15	
	Q2:05: Ofrimi i mbështetjes për bizneset artizanale	Q2:05:PG1: Lehtësimi i procedurave administrative në ndihmë të bizneseve artizanale tradicionale dhe ofrimi i trajnimit për artizanë të rinj	Q2:05:PG1:p1: Hartimi i një politike të qytetit për të caktonuar diferencimin e taksave vendore për bizneset e artizanatit Q2:05:PG1:p2: Ngritja e kurseve afatshkurtra të trajnimit për njerëzit që duan të punësohen ose sapa janë punësuar në bizneset tradicionale të artizanatit	16	
					17
					18
					19
					20
					21

Qëllimi	Objektivi	Programi	Projekti	Nr
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit	Q3:O1: Harmonizimi i planeve sektoriale lokale dhe qendrore brenda kuadrit të Planit të Përgjithshëm Rregullator të qytetit	Q3:O1:PG1: Konsolidimi i aktiviteteve në lidhje me planifikimin urban të qytetit dhe i logjistikës së nevojshme	Q3:O1:PG1:p1: Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të Zyrës së Planifikimit Urban në bashki	22
			Q3:O1:PG1:p2: Krijimi i hartës fotografike të qytetit dhe përditësimi i infrastrukturës inxhinierike	23
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit	Q3:O2: Përmirësimi i infra-strukturës dhe rritja e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve	Q3:O2:PG1: Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i asaj të re në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane	Q3:O1:PG1:p3: Hartimi i një drafti të përgjithshëm të Planit Rregullator të qytetit	24
			Q3:O1:PG1:p4: Hartimi i planeve të pjesshme rregullatore për pjesë të qytetit me vlera të veçanta historike ose kulturore	25
			Q3:O1:PG1:p5: Përgatitja e projektit për ndërtimin e unazës së qytetit	26
			Q3:O1:PG2:p1: Institucionalizimi i një takimi periodik gjatshëm me aktorët vendas për monitorimin dhe rishikimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik të Beratit	27
			Q3:O2:PG1:p1: Rikonstrukcioni i sistemeve të të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, si dhe ofrimi i një marrëveshjeje koncesionare për menaxhimin e tij	28
			Q3:O2:PG1:p2: Rikonstrukcioni i linjës së furnizimit me energji elektrike 20 kV të qytetit	29
			Q3:O2:PG1:p3: Zgjerimi i rrjetit ekzistues të linjës së tele-fonisë fikse të qytetit	30
			Q3:O2:PG1:p4: Rikonstrukcioni i sistemit të kanaleve të kullimit të ujërave sipërfaqësore në lagjen “Murat Çelebi”	31
			Q3:O2:PG1:p5: Rikonstrukcioni i rrugës “Babe Dudë – Mulliri i Xhamos”	32
			Q3:O2:PG1:p6: Rikonstrukcioni i fasadave të ndërtesave në rrugët kryesore të qytetit	33
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit	Q3:O2:PG1:p7: Ndërtimi i tregut me pakicë në lagjen “Murat Çelebi”	Q3:O2:PG1:p8: Ndërtimi i një kanali të lartë për kullimin e ujërave në lagjen “Barrikadë”	Q3:O2:PG1:p7: Ndërtimi i tregut me pakicë në lagjen “Murat Çelebi”	34
			Q3:O2:PG1:p9: Rikonstrukcioni i rrugës në lagjen “Goricë”	35
			Q3:O2:PG1:p10: Rikonstrukcioni i rrugës së ish NG në lagjen “Dëshmorët e Kombit”	36
			Q3:O2:PG1:p11: Ndërtimi i një jetimore në qytet	37
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit			Q3:O2:PG1:p11: Ndërtimi i një jetimore në qytet	38



Qëllimi	Objektivi	Programi	Projekti	Nr	
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit		Q3:O2:PG1: Reabilitimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i asaj të re në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane	Q3:O2:PG1:p12: Rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori”	39	
		Q3:O2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve	Q3:O2:PG2: Forcimi i kapaciteteve mirëmbajtëse të ofruesve të shërbimit publik si dhe përcaktimi i standardeve të ofrimit të këtyre shërbimeve	Q3:O2:PG1:p13: Rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori” Q3:O2:PG1:p14: Rikonstrukcioni i qendrës së lojërave me dorë	40 41
			Q3:O2:PG3: Vendosija e një kostoje të përshtatshme: raporti i tarifës së ofrimit e shërbimeve në përputhje me politikat sociale të bashkisë	Q3:O2:PG2:p1: Zhvillimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve publike dhe bizneseve të kontraktuara që ofrojnë shërbime në qytet, me anë të përpilimit dhe realizimit zbatimit të standardeve dhe normave tekniko-ekonomike	42
			Q3:O2:PG3: Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe social në qytet	Q3:O2:PG3:p1: Kryerja e një studimi për balancimin e kostove me tarifave për ofrimin e shërbimeve në qytet	43
			Q3:O3: Arritja e normave optimale mjedisore në qytet	Q3:O2:PG4: Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe social në qytet	Q3:O2:PG4:p1: Përgatitja e një paketë masash për ngritjen e standardeve të shërbimeve sociale që iu ofrohen grupeve të marxhimalizuara
	Q3:O3:PG1: Menaxhimi i mjedisit me anë të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjes së burimeve njerëzore dhe logjistike	Q3:O3:PG1:p1: Ngrija e një sistemi për kontrollin e nivelit të ndotjes të shkaktuar nga bizneset që veprojnë në nivel bashkie ose qarku		45	
	Q3:O3:PG1:p2: Sigurimi i pajisjeve të nevojshme për analizimin dhe monitorimin e standardeve mjedisore dhe i trajnimit të kërkuar për të përdorur pajisjet	Q3:O3:PG1:p3: Organizimi çdo 3-muaj, i tryezës së rrum-bullakë t midis institucioneve dhe organizatave që veprojnë në fushën e mjedisit për të diskutuar mbi çështjet e mbrojtjes së mjedisit		46	
				Q3:O3:PG1:p4: Përgatitja e hartave të “Vlerësimit të Ndikimit të Mjedisit” të qytetit dhe hartimi i planeve të veprimit eliminimin e kërcënimeve	47 48

Qëllimi	Objektivi	Programi	Projekti	Nr
Qëllimi 3: Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkë kohorë dhe në harmoni me tiparet specifike të qytetit	Q3:O3: Arritja e normave optimale mjedisore në qytet	Q3:O3:PG2: Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në zgjidhjen e problemeve mjedisore	Q3:O3:PG2:p1: Përgatitja e publikimeve për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit për mjedisin në qytet	49
			Q3:O3:PG2:p2: Organizimi në media i një programi debati publik për të rritur në komunitet ndërgjegjësimin në lidhje me problemet e mjedisit	50
			Q3:O3:PG2:p3: Organizimi i takimeve mujore me pjesë marrjen përfaqësuese të Komisionit të Qytetarëve, Unionin Studentor, të bizneseve dhe OJQ vendore për të diskutuar në lidhje me çështjet e mjedisit	51
			Q3:O3:PG2:p4: Vendosja në bashki e një linje komunikimi direkte elektronike për të pritur ankesat dhe sugjerimet lidhur me problemet mjedisore që shqetësojnë komunitetin	52



c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik

KB, Komuniteti i Biznesit; DhTI, Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë; D, Donatorë; DBU, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit; DM, Drejtoria Rajonale e Mjedistit; DSh, Drejtoria Rajonale e Shëndetit; Q, Qeveria Qendrore; IMK, Instituti i Monumenteve të Kulturës; KI, Komuniteti lokal; B, Bashkia; MM, Ministria e Mjedistit; MSh, Ministria e Shëndetësisë; KQ, Këshilli i Qarkut; NVM, Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mëdha; T, Turistët.

Nr i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (€) *	Burimet e financimit								Zbatimi			Grupet e synuara
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donatorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fund	
				%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë				
1	Q1:O1:PG1-p1: Përgatitja e studimit për integrimin e mjediseve të bizneseve agrare në planin urban të qytetit	250,000	2,000	50	125,000	0	0	35	87,500	15	37,500	B, KQ, DhTI	2008	2009	KI, NVM
2	Q1:O1:PG1-p2: Përgatitja e studimit për ngrijen në qytet të një parku për biznesin agrar për grumbullimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore të qarkut	1,875,000	15,000	50	937,500	0	0	0	0	50	937,500	B, KQ, DhTI	2008	2008	KI, NVM
3	Q1:O1:PG2-p1: Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku ekzistojnë tashmë bizneset agrare	18,750,000	150,000	40	7,500,000	0	0	50	9,375,000	10	1,875,000	B, KESH, DhTI	2008	2009	KI, KB
4	Q1:O2:PG1-p1: Ngritja pranë bashkisë e Zyrës së Asistencës "One-Stop-Shop" për të lehtësuar procedurat e bizneseve	3,125,000	25,000	60	1,875,000	10	312,500	0	0	30	937,500	B, KQ, DhTI	2005	2006	KI, NVM
5	Q1:O2:PG1-p2: Përgatitja e studimit mbi politikat fiskale vendore për bujqësinë	375,000	3,000	70	262,500	0	0	0	0	30	112,500	B, KQ, DhTI	2006	2007	KI, NVM
6	Q1:O2:PG1-p3: Publikimi i broshurës mbi mundësitë dhe kushtet e kreditimit të biznesit agrar vendor	62,500	500	10	6,250	0	0	0	0	90	56,250	B, DhTI	2008	2008	KI, KB

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (€) *	Burimet e financimit								Zbatimi			Grupet e synuara
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donatorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fund	
				%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë				
7	Q1:02:PG1:p4: Organizimi i seminareve periodike mbi zhvillimet rajonale të biznesit agrar me pjesë marrjen e dhe institucionet e interesuara	1,250,000	10,000	20	250,000	0	0	10	125,000	70	875,000	B, DhTI	2005	2010	KI, KB
8	Q1:03:PG1:p1: Ngritja e një shoqate të biznesit agrar	375,000	3,000	5	18,750	20	75,000	0	0	75	281,250	B, KQ, DhTI	2006	2007	KI, KB
9	Q1:03:PG1:p2: Organizimi i panairit periodik të produkteve bujqësore	1,000,000	8,000	15	150,000	40	400,000	0	0	45	450,000	B, DhTI, D	2007	2010	KI, KB
10	Q1:03:PG1:p3: Publikimi periodik i buletimit bujqësor dhe blegtoral	1,250,000	10,000	10	125,000	0	0	20	250,000	70	875,000	B, KQ, DhTI, DBU	2005	2006	KI, KB
11	Q1:04:PG1:p1: Përgatitja e një buletimi informues mbi standartet bujqësore dhe tendencat e tregut si në rajon dhe jashtë vendit	625,000	5,000	20	125,000	10	62,500	0	0	70	437,500	B, KQ, DhTI	2007	2008	KI, KB
